

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në pushtetin lokal

gapo INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



—
Maj 2020

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në pushtetin lokal

—
Maj 2020

— Përmbajtja

3 Përmbledhje ekzekutive

4 Masat e ndërmarra nga komunat
në frenimin e përhapjes së
pandemisë COVID-19

6 Efektet në buxhetin e komunave
nga pandemia COVID-19

9 Efektet në investimet kapitale në
komuna nga pandemia COVID-19

10 Efektet e pandemisë COVID-19
në punësim

12 Përfundim

13 Aneks

Përmbledhje ekzekutive

Nga 13 marsi 2020, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë masat e para në nivel vendi për të frenuar përhapjen e pandemisë COVID-19. Masat e ndërmarra përfshijnë kufizimin e lëvizjes dhe takimeve, ndërprerjen e punës në shkolla dhe universitete, pezullimin e pjesës dërmuese të aktiviteteve biznesore, ndërprerjen e transportit urban dhe ndërrurban. Këto masa kanë prekur të gjitha komunat, duke përfshirë edhe ato të cilat nuk kanë ende asnjë rast të identifikuar me COVID-19. Deri më 27 maj 2020, në Kosovë janë evidentuar 1048 raste me COVID-19, në 31 komuna. Kjo gjendje ka ndikuar në dy rrafshë, atë publik dhe privat. Në sektorin publik, ndikimi ka qenë në kufizimin e mundësisë për investime publike, në ofrimin e kufizuar të shërbimeve publike dhe administrative, pamundësinë e komunave në ndërmarrjen e procedurave të prokurimit publik, anulimin e takimeve të organeve kolektive komunale, si dhe anulimin e konsultimeve publike. Ndërsa, në sektorin privat, më të prekur janë sektori i ndërtimtarisë, hotelerisë, gastronomisë, tekstilit si dhe pjesa më e madhe e shërbimeve.

Në të gjitha komunat, të hyrat komunale gjatë gjysmës së dytë të muajit mars dhe në muajin prill kanë shënuar rënie prej 45% deri 90%. Të gjitha kategoritë nga ku komunat sigurojnë të hyra janë prekur nga masat kundër përhapjes së COVID-19. Në bazë të raportimeve të komunave në Ministrinë e Financave dhe Transfereve (MFT), në muajin mars dhe prill të 2020, të gjitha komunat kanë arkëtuar të hyra në vlerë 5.8 milionë euro, apo rreth 9.3 milionë euro më pak krahasur me muajt e njejtë të vitit të kaluar. Komunat do të dalin të dëmtuara në të hyra vetanake veçmas nga kategoria e tatimit në pronë, nga gjobat policore në rrugët lokale, nga vendimet e gjykatave dhe nga shfrytëzimi i hapësirave publike nga ana e gastronomisë. Një pjesë e komunave kanë aprovuar pako ekonomike ku kanë paraparë faljen e shumicës së pagesave që janë planifikuar të bëhen në 2020 nga bizneset. Ndërsa, gjobat në trafik kanë rënë për 90%. Në muajin shkurt 2020 (para ndërmarrjes së masave), policia në tërë vendin ka shqiptuar mbi 43,000 gjoba për shkelësit e rregullave në komunikacion, ndërsa në muajin prill 2020, kanë qenë të shqiptuara 4,462 gjoba në nivel vendi.

Përveç të hyrave vetanake, komunat nuk do të arrijnë t'i përmbushin as planet e parapara në fushën e investimeve kapitale. Nga hulumtimi i zhvilluar në 16 komuna ka dalur që janë së paku 124 projekte kapitale që do të shtyhen si pasojë e gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19.

Kjo gjendje ka ndikuar edhe në rënien e numrit të të punësuarëve. Sipas të dhënave të Fondit të Kursimeve Pensionale (Trusti), në muajin mars ka më pak kontributpagues nga secila komunë krahasuar me muajin dhjetor 2019.

Masat e ndërmarrja nga komunat në frenimin e përhapjes së pandemisë COVID-19

Komunat kanë luajtur rol aktiv në ndërmarrjen e masave në parandalimin e përhapjes së virusit. Të gjitha komunat e Kosovës kanë aktivizuar shtabet lokale të krizave dhe kanë krijuar grupet operative në terren. Shtabet e krizave janë përbërë nga kryetarët e komunave, drejtorët e Drejtorisë së Shëndetësisë, drejtorët e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe komandantët e policisë. Ndërsa, grupet operative janë përbërë nga drejtorët e inspektionit dhe rendit komunal, sektori i sanitarisë, sektori i shërbimeve publike dhe sektori i mirëqenies sociale. Përveç këtyre masave, komunat janë koordinuar në vazhdimësi për vendimet dhe masat e ndërmarrja nga niveli qendror për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19.

Deri në gjysmën e muajit maj 2020, katër komuna kanë miratuar pako emergjente ekonomike (Prishtina, Drenasi, Ferizaj dhe Hani i Elezit) ndërsa dy komuna (Podujeva, Lipjani) kanë miratuar masa të pjeshme ekonomike në komunat e tyre (duke i liruar bizneset nga pagesat në obligimet komunale). Pakoja ekonomike e Komunës së Prishtinës përmban 14 masa. Në mesin e tyre hyjnë edhe masa lehtësuese për biznese, si lirimi nga qiraja e ndërmarrjeve dhe lokaleve që janë në pronësi të komunës deri në fund të muajit qershor 2020, lirimi nga pagesat për lokalet hoteliere që kanë shfrytëzuar hapësirat publike komunale për vendosjen e tarrasave, apo subvencionimin e pagës për gjithë punonjësit e ndërmarrjes lokale "Trafiku Urban". Komuna e Prishtinës ka subvencionuar edhe pagat e punëtorëve të çerdheve publike në kryeqytet dhe janë liruar nga pagesa e çerdheve prindërit që kanë pasur kontrata me këto institucione edukativo-arsimore. Prishtina ka subvencionuar me një grant në vlerë prej 250,000 eurove të gjitha ndërmarrjet lokale (Hortikultura, Sport Marketing, Pastrimi) dhe po ashtu ka ndarë subvencione të posaçme për kulturë, rini dhe sport në vlerë prej 100,000 euro.¹

Kuvendi Komunal i Drenasit ka liruar (falur) të gjitha bizneset që funksionojnë në këtë komunë nga obligimet që kanë pasur ndaj komunës për tërë vitin 2020, ku hyjnë edhe obligimet nga shfrytëzimi i hapësirave publike. Ndërsa pagesat për lejet ndërtimore janë shtyrë për pjesën e dytë të vitit.² Njësoj kanë vepruar edhe komuna e Ferizajt dhe ajo e Hanit të Elezit, por nga këto dy komuna lirimi i bizneseve nga obligimet komunale do të vlejë vetëm për gjashtëmuajorin e parë të vitit.³

Qeveria e Kosovës në fillim të muajit prill ka ndarë një shumë prej 170 milionë eurove për të lehtësuar efektet negative që ka shkaktuar pandemia COVID-19. Nga kjo shumë 10 milionë euro janë paraparë për komuna (sipas pikes 5 të planit operacional) Aty precizohet se kjo shumë do t'u ndahet komunave bazuar në numrin e banorëve, efektet e drejtpërdrejta që ka pasur pandemia si dhe nisuar nga faturat e shpenimeve që do t'i paraqesin komunat që ka pasur si rezultat i masave të ndërmarrja për të parandaluar përhapjen e pandemisë.⁴

1 Komuna e Prishtinës. Faqja zyrtare. Pako ekonomike emergjente. Burim: <https://bit.ly/2SvtqBz>

2 Komuna e Drenasit. Faqja zyrtare. Njoftim lidhur me lirimin nga pagesa për bizneset.









Burim: <https://bit.ly/2SvtHeB>

3 Komuna e Ferizajt. Vendimi i kryetarit për lirim nga pagesa e bizneseve. Burim: <https://bit.ly/3bUGNcR>

4 Ministria e Financave dhe Transfereve. Plani operacional për pakon Fiskale Emergjente. Pika 5.

Burim: <https://bit.ly/3e7FnMZ>

Tabela 1. Masat e ndërmarra nga komunat në frenimin e përhapjes së virusit COVID-19


Komuna	Shtab emergjent lokal 	Pako ekonomike emergjente komunale 	Themelimi i ekipit të vullnetarëve 	Tunel dezinfektues në hapësira publike 	Dezinfektim i ndërtesave kolektive/private 	Dezinfektim i rrugëve, shesheve, parqeve 	Ofrimi i pakove ushqimore 	Ofrimi i pakove higjienike 
Deçan	E ndërmarrë	Pjesërisht	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Pjesërisht	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Dragash	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Pjesërisht	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Drenas	E ndërmarrë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Ferizaj	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Fushë Kosovë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Pjesërisht	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Gjakovë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Pjesërisht	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë
Gjilan	E ndërmarrë	Pjesërisht	Pjesërisht	Nuk është ndërmarrë	Pjesërisht	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Hani i Elezit	E ndërmarrë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Pjesërisht	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Istog	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Pjesërisht	Pjesërisht	Pjesërisht	Pjesërisht
Junik	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk aplikohet	Pjesërisht	Pjesërisht	Pjesërisht
Kaçanik	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Pjesërisht	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Kamenicë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	Pjesërisht	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Klinë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Lipjan	E ndërmarrë	Pjesërisht	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Malishevë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Mitrovicë e Jugut	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Obiliq	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Pejë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Podujevë	E ndërmarrë	Pjesërisht	Pjesërisht	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Prishtinë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Prizren	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Rahovec	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Shtërpcë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Pjesërisht	Pjesërisht	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Shtime	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk aplikohet	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Skenderaj	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Suharekë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Viti	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë
Vushtrri	E ndërmarrë	Nuk është ndërmarrë	Pjesërisht	Nuk është ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë	E ndërmarrë

Burimet: Faqet zyrtare në internet të komunave të Kosovës

Efektet në buxhetin e komunave nga pandemia COVID-19

Të hyrat vetanake të komunave do të bien dukshëm në gjashtëmujorin e parë të 2020. Rënia e të hyrave vetanake do të përcillet edhe me rënien e shpenzimeve në të gjitha kategoritë buxhetore, sidomos investimet kapitale ngase të hyrat vetanake shfrytëzohen kryesisht për investime kapitale. Në bazë të raportimeve të komunave në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, në muajin mars dhe prill të 2020, të gjitha komunat e Kosovës kanë arkëtuar të hyra në vlerë afro 5.8 milionë euro, apo rreth 9.3 milionë euro më pak krahasur me muajt e njëjtë të vitit të kaluar.⁵

Grafikoni 1. Të hyrat e realizuara nga komunat në katër mujorin e 2020 krahasur me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar sipas të dhënave nga Ministria e Financave dhe Transfereve (vlera në euro)



Efektet më të mëdha do të jenë te rënia e të hyrave nga tatimi në pronë. Ministria e Financave dhe Transfereve ka hequr si obligim pagesën e tatimit në pronë si kusht për ta regjistruar automjetin në komunë. Për periudhën nga gjysma e muajit mars deri në muajin qershor të vitit 2020, automjetet mund të regjistrohen vetëm me pagesën e polisës së sigurimit.⁶ Tatimi në pronë, paraqet të hyren kryesore për pjesën më të madhe të komunave. Përveç kësaj, edhe të hyrat tjera që realizon komuna do të bien dukshëm, ngase të gjithë sektorët prej nga vjelë të hyra pushteti lokal janë të prekura nga masat e ndërmarra për frenimin e pandemisë COVID-19.

⁵ Ministria e Financave. Drejtoria e Thesarit. Intervistë me Drejtorin e Departamentit të Thesarit, z. Ahmet Ismaili. 16.04.2020. Intervista është realizuar nëpërmjet E-mail zyrtar.

⁶ Ministria e Financave dhe Transfereve. Publikimi lidhur me tatimin në pronë. Burim: <https://bit.ly/35svyWG>

Në gjashtëmujorin e parë të 2019, 27 komuna, kanë realizuar të hyra në vlerë rreth 40 milionë euro.⁷ Ndërsa 38 komunat e Kosovës për vitin 2020 kanë planifikuar të hyra vetanake në vlerë rreth 83 milionë euro.⁸ Pas tatimit në pronë, një e hyrë tjetër që e ka mbushur arkën e komunave kanë qenë dënimet e shqiptuara nga policia në rrugët lokale për shkelësit e rregullave në komunikacion. Para ndërmarrjes së masave për frenimin e pandemisë COVID-19, Policia e Kosovës ka shqiptuar brenda 24 orëve deri në 1,500 gjoba. Pas marrjes së masave ndaj pandemisë, numri i gjobave të shqiptuara ka qenë nga 70 deri në 130 brenda ditës në nivel vendi. Përveç kësaj, as gjykatat nuk janë marrë me lëndë administrative ose civile (si rastet e parashtruara nga inspekcioni komunal ose policia) që kanë pasur natyrë kontestimore e një pjesë e të cilave zakonisht përfundojnë në favor të të hyrave komunale.⁹

Tabela 2. Numri i gjobave të shqiptuara nga policia në nivel vendi para dhe pas masave të ndërmarra në frenimin e COVID-19

Periudha 2020	Java e parë	Java e dytë	Java e tretë	Java e katërt	Totali
Muaji shkurt	9,852	11,411	10,563	11,230	43,056
Muaji mars	10,769	10,346	859	689	22,663
Muaji prill	1,357	1,382	658	1,065	4,462

Burim: Policia e Kosovës

E hyrë e tretë vetanake e rëndësishme nga pjesa më e madhe e komunave konsiderohen të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike. Komunat do ta kenë të pamundur të inkasojnë të hyra së paku për muajt mars-qershor 2020. Disa komuna, si Prishtina, Drenasi, Ferizaj, kanë nxjerrë vendime përkatëse për lirimin e bizneseve nga pagesa e shfrytëzimit të pronës komunale për periudhën e lartcekur.¹⁰

Për një numër të komunave, veçmas ato të mëdha, e hyrë vetanake me rëndësi paraqiten taksat që paguajnë kompanitë ndërtimore për lejet e ndërtimit. Këto pagesa nuk mund të anulohen (përgjatimisht rasteve kur mund të falimentojë kompania aplikuese për leje) por Prishtina, Prizreni dhe Gjilani tanimë kanë nxjerrë vendime për shtyrjen e afatit të pageses së këstit, çka nënkupton se planifikimi fillestar i komunave për të hyra komunale do të pësojë ndryshime thelbësore.¹¹

Komunat planifikojnë që në qershor të 2020 të thërrasin mbledhje të jashtëzakonshme të kuvendeve komunale me qëllim të rishikimit të buxhetit. Në dy vitet e kaluara, kjo nuk ka qenë e mundur të bëhet nga komunat për shkak të mos rishikimit të buxhetit nga niveli qendror. Buxheti pritet të rishikohet të pjesa e të hyrave vetanake dhe te pjesa e investimeve kapitale.¹²

7 27 komuna janë referuar, ngase pjesa tjetër e komunave nuk i kanë publikuar të dhënat e buxhetit për periudhën janar-qershor 2019. Të dhënat buxhetore për gjashtëmujorin e parë të 2019 janë marr nga faqet zyrtare të komunave ku janë publikuar raportet përkatëse financiare.

8 Ministria e Financave dhe Transfereve. Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Fq 22. Pjesa e III. Burim: <https://bit.ly/2KRLiZO>


9 Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Njoftimet. Burim: <https://bit.ly/zybEm7f>

10 Komuna e Drenasit. Faqja zyrtare. Njoftim lidhur me lirimin nga pagesa për bizneset. Burim: <https://bit.ly/2SvtHeB>

11 Komuna e Prishtinës. Faqja zyrtare. Pako ekonomike emergjente. Burim: <https://bit.ly/2Svtqzb>

12 Koonfirmimë nga komunat e Kosovës. GAP ka zhvilluar bisedë telefonike me 23 komuna të Kosovës me drejtoret e financave të cilët e kanë paraqitur të domosdoshmëm rishikimin buxhetor në këtë vit.

Grafikoni 2. Të hyrat që kanë pasur komunitat në gjashtëmujorin e parë të 2019 në kategoritë që mund të kenë rënie të madhe të hyrash në gjashtëmujorin e 2020 # vlera në euro



Në 30 komuna të Kosovës¹³ në katër kategori të hyrash komunale (të lartcekura në grafikun) në gjashtëmujorin e parë të 2019 janë arkëtuar rreth 20 milionë euro. Duke u bazuar në të hyrat vetanake të komunave për muajt mars dhe prill 2020, komunitat do të kenë rënie të të hyrave edhe në muajt maj-dhjetor 2020, ngase niveli lokal dhe qendror ka dhënë shenja se do të zgjerojë pakon fiskale për tërë vitin 2020. Megjithatë, në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023, e publikuar nga MFT gjatë muajit maj 2020, parashikohet një rënie e lehtë e të hyrave vetanake të komunave. Sipas KASH 2021-2023, me rishikimet buxhetore për vitin 2020, projektimi i të hyrave nga tatimi në pronë është ulur nga 31 milionë euro në 29 milionë euro, kurse të hyrat nga taksat dhe ngarkesat tjera do të ulen nga 50 milionë euro në 47 milionë euro¹⁴. Mirëpo, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka parashikuar një rënie më të madhe të të hyrave komunale se sa MFT. Sipas FMN-së, të hyrat nga tatimi në pronë dhe taksat komunale do të bien në 24 milionë dhe 45 milionë euro, respektivisht.¹⁵

¹³ Në grafikun janë përfshirë komunitat që i kanë publikuar të dhënat e detajuara për të hyrat komunale. Tetë komuna të tjera i kanë të dhënat e përgjithshme, jo të ndara sipas kategorive.

¹⁴ Ministria e Financave dhe Transfereve. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023, faqe 84. Maj 2020
Burimi: <https://bit.ly/36e09l1>

¹⁵ Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Raport për Republikën e Kosovës, nr.20/112. Burimi: <https://bit.ly/2TnDpAo>

Rënia e të hyrave komunale është konstatuar edhe në vlerësimin që komunat kanë bërë për periudhën mars dhe prill. Në Komunën e Kamenicës, në periudhën janar-mars 2020, shkalla e rënies së të hyrave vetanake (krahasur me periudhën e njejtë të vitit të kaluar) është minus 9.52%, ndërsa periudha janar-shkurt 2020, kur Kosova akoma nuk kishte marrë masa kundër pandemisë, shkalla e të hyrave komunale në Kamenicë ka qenë 13.53% me lartë se sa periudha e njejtë e vitit të kaluar.¹⁶ Nga 13 marsi 2020, kur janë ndërmarrë masat e para kundër frenimit të përhapjes së pandemisë deri në fund të atij muaji (mars), në Komunën e Kamenicës shkalla e të hyrave komunale ka rënë për 43.87%. Ndërsa gjatë tërë muajit prill (2020), kjo komunë ka pësuar rënie të hyrash komunale në vlerë prej 84% në krahasim me muajin e njejtë të vitit të kaluar. Mos realizimi i të hyrave apo mos inkasimi sipas planifikimit në bazë të Ligjit të Buxhetit, mund të shkaktojë edhe mos shpërndarje të alokimeve buxhetore nëpër kategori ekonomike dhe mos fillim të aktiviteteve të furnizimit, shërbimeve dhe aktiviteteve të prokurimit.¹⁷

Gjendje e njejtë është në të gjitha komunat e tjera, si në Prishtinë, Drenas, Obiliq, Graçanicë, Fushë Kosovë, Ferizaj, Gjakovë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Podujevë, Shtime dhe Kaçanik. Në Komunën e Graçanicës, rënia e të hyrave për periudhën mars-prill është rreth 85%, e përafërt me këtë vlerë është edhe rënia e të hyrave komunale në Mitrovicë dhe Obiliq.¹⁸ Komunat do të kenë me pak të hyra edhe nga pagesa e taksës për leje ndërtimore, të hyrat nga ndërrimi ose destinimi i tokës, të hyrat nga ushtrimi i veprimtarisë afariste dhe të hyrat nga ofiçaria dhe qiraja në objektet e lëshuara komunale për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme.

E ndikuar nga kjo gjendje ka dalur edhe sektori i gjeodezisë dhe kadastrit. Puna e këtij sektori pothuajse është pezulluar gjatë periudhës së pandemisë në të gjitha komunat. Edhe kjo pritet të ndikoj në shkallen e të hyrave komunale.¹⁹

Efektet në investimet kapitale në komuna nga pandemia COVID-19

Investimet kapitale të planifikuara nga komunat për t'u realizuar në vitin 2020, disa do të vonohen e disa tjera do të mund të anulohen, për shkak të tre faktorëve: 1) ndryshimi i planit dinamik; 2) rishikimi i buxhetit apo shkurtimi në alokime si pasojë e rënies së të hyrave të përgjithshme buxhetore; 3) parashikimi që të hyrat vetanake të komunave do të pësojnë rënie të theksuar.

Në disa komuna nuk janë ndërprerë krejtësisht punët në disa projekte, por këto projekte kanë qenë të bartura si investime nga 2019 ose kanë filluar para datës 13 mars 2020, kur kanë hyrë në fuqi masat e para në nivel vendi për parandalimin e pandemisë COVID-19. Komunat kanë pasur problem t'i vazhdojnë punimet e kontraktuara edhe për faktin se fuqia punëtore në disa raste nuk ka mundur të levizë nga një komunë në tjetren, shkak i masës së karantinës të ndërmarrë në disa komuna.²⁰

Në përgjithësi, pas datës 13 mars 2020, komunat e kanë pasur të pamundur të ndërmarrin procedura sipas planeve të parapara për investime. Kjo ka ardhur

16 Komuna e Kamenicës. Intervistë me Kryetarin e Komunës, z. Qëndron Kastrati. 15.04.2020. Intervista është realizuar nëpërmjet e-mail zyrtar.

17 Komuna e Mitrovicës. Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Financave, Shukri Gashi. 10.04.2020. Intervista është realizuar nëpërmjet bisedës telefonike.

18 Komuna e Obiliqit. Intervistë me Shefin e Kabinetit të Kryetarit të Komunës, z. Abdurrahman Krasniqin. 16.04.2020. Intervista është realizuar nëpërmjet E-mail zyrtar.

19 Komuna e Hanit të Elezit. Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të mjedisit. Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë, z. Nexhmedin Daci. 10.04.2020. Intervista është realizuar nëpërmjet bisedës telefonike.

20 Komuna e Prishtinës. Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontraktave, z. Gëzim Mehmeti. 10.04.2020. Intervista është realizuar nëpërmjet bisedës telefonike.

për arsye se komunat janë fokusuar në ndërmarrjen e masave në luftimin dhe parandalimin e COVID-19 dhe shpenzimet buxhetore janë orientuar në këtë plan si dhe pamundësia e komunave për të zhvilluar proces të drejtë, të barabartë dhe të hapur të prokurimit publik, që do të mundësonte kontraktimin e punëve në fushën e investimeve kapitale.²¹ Me një vendim të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, të datës 15 prill 2020, komunave u është ndalur ndjekja e procedurave të prokurimit për secilën kategori, përveç kontratave të lidhura me negociim që lidhen me masat ndaj pandemisë COVID-19.²²

Efektet në investime kapitale nëpër komuna nga gjendja e krijuar nga pandemia COVID-19 është konfirmuar edhe nga Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT). Ata kanë paraparë që në periudhën e parë (Janar-Qershor), projektet që do të pamundësohen në mënyrë të drejtpërdrejt do të jenë ato që janë paraparë të realizohen nga të hyrat vetanake të komunave.²³ Komunat kanë paraqitur planifikimet (në shtator të 2019) në sistemin PIP (Platforma për Investime Publike), e cila është pjesë e MFT, në lidhje me investimet kapitale dhe shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Për shkak të masave ndaj pandemisë, tani pjesa më e madhe e planifikimeve të parapara nga komunat do të ndryshojë, e për rrjedhojë do të kërkohet një riplanifikim tjetër nga komunat.²⁴

Në një hulumtim të bërë nga Instituti GAP në 16 komuna të Kosovës²⁵, del se janë së paku 124 projekte kapitale që do të ndikohen në formë të drejtpërdrejtë nga masat e ndërmarrja në parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19. Vlera e parashikuar e këtyre projekteve është 15.8 milionë euro (shih aneksin në këtë raport).

Efektet e pandemisë COVID-19 në punësim

Masat kufizuese, si pasojë e pandemisë, kanë ndikuar edhe në punësim në nivelin lokal. Në të gjitha komunat e Kosovës ka rënie të kontributpagesve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti). Sipas Pakos Fiskale Emergjente, të bërë publike nga Qeveria e Kosovës²⁶, parashihet edhe asistencë prej 170 euro në muaj për pagat e punëtorëve për ato shoqëri tregtare të cilat janë në vështirësi financiare (masa 3, pika a), si dhe asistencë financiare pej 130 euro në muaj për ata që e humbin vendin e punës.²⁷ Në bazë të këtyre masave, sipas ministrit të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, deri më 13 maj 2020 janë humbur vetëm 1,400 vende të punës.²⁸

Por të dhënat e Trustit dëshmojnë se sa vende të punës janë prekur si pasojë e masave kufizuese për parandalimin e pandemisë dhe numrin e punëtorëve për të cilët nuk janë paguar kontributet pensionale.

21 Komuna e Obiliqit. Intervistë me Shefin e Kabinetit të Kryetarit të Komunës, z. Abdurrahman Krasniqin. 16.04.2020. Intervista është realizuar nëpërmjet E-mail zyrtar.

22 Televizioni "Kohavision". Datë 26 prill 2020. Lajmet qendrore. Burimi: <https://bit.ly/2Z13x7y>

23 Ministria e Financave. Drejtoria e Thesarit. Intervistë me Drejtorin e Departamentit të Thesarit, z. Ahmet Ismaili. 16.04.2020. Intervista është realizuar nëpërmjet E-mail zyrtar.

24 Komuna e Mitrovicës. Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Financave, z. Shukri Gashi. 10.04.2020. Intervista është realizuar nëpërmjet bisedes telefonike.

25 Edhe në komunat e tjera të Kosovës do të këtë ndikim pandemia në investimet kapitale, por deri në gjysmen e dytë të muajit maj 2020 nuk ka ekzistuar një vlerësim përkatës se cilat projekte do të ndikohen nga pandemia.

26 Ministria e Financave dhe Transfereve. Vendim 31/2020. Burim: <https://bit.ly/2TIX08A>

27 Zyra e Kryeministrit. Kryeministri në detyrë Kurti prezanton masat e parapara në Pakon Fiskale Emergjente, 14 prill 2020. Burimi: <https://bit.ly/2T6MixO>

28 Telegrafi.com. Bislimi: U formalizuan 12 mijë vende pune, vetëm 1,400 prej tyre kanë humbur punën, 13 maj 2020. Burimi: <https://bit.ly/2LuWHPB> (hapur së fundmi më 15 maj 2020).

Tabela 3. Ndikimi i pandemisë në numrin e kontributpaguesve pensional sipas komunave

Komuna	31 dhjetor 2019	31 mars 2020	30 prill 2020
Prishtinë	69,881	54,956	59,133
Prizren	30,933	21,243	24,363
Ferizaj	23,011	15,966	18,250
Gjilan	21,693	15,285	17,538
Pejë	20,683	15,355	17,247
Gjakovë	19,813	13,691	15,751
Podujevë	17,760	12,810	14,341
Mitrovicë	16,326	11,440	13,673
Vushtrri	15,570	11,597	12,998
Lipjen	12,573	8,894	9,932
Drenas	12,297	9,180	10,214
Suharekë	10,763	7,078	8,118
Skënderaj	9,967	7,393	8,101
Fushë Kosovë	9,832	7,772	8,393
Rahovec	8,668	5,801	6,880
Istog	7,777	5,608	6,251
Malishevë	7,741	4,956	5,733
Viti	7,423	5,063	5,870
Kamenicë	6,450	4,425	5,106
Klinë	6,188	4,215	4,808
Kaçanik	5,917	4,024	4,677
Obiliq	5,815	4,567	4,906
Deçan	5,365	3,847	4,349
Shtime	4,939	3,374	3,913
Dragash	4,379	2,857	3,349
Graçanicë	2,183	1,577	1,749
Leposaviç	2,150	1,115	1,151
Shtërpcë	1,637	1,119	1,223
Mitrovicë V.	1,502	1,053	1,057
Hani i Elezit	1,473	1,091	1,232
Zveçan	1,305	662	699
Zhubin Potok	1,105	724	769
Junik	613	444	488
Mamushë	598	364	435
Novobërdë	583	378	415
Ranillug	504	342	353
Klllokot	501	345	379
Partesh	396	272	276

Burimi: Trusti i Kursimeve Pensionale

Përfundim

Komunat kanë treguar potencial të mirë në menaxhimin institucional dhe ndërmarrjen e masave në parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19. Përveç rolit sensibilizues, komunat kanë dëshmuar rol të mirë koordinues me nivelin qendror dhe kjo qasje ka dhënë rezultate të mira në ruajtjen e shëndetit publik. Të gjendur përballë një situatë krejtësisht të re, komunat do të detyrohen t'i ndryshojnë planifikimet e mëhershme. Kjo përveç që do të ndikojë në dinamikën e punëve nëpër komuna, në të njëjtën kohë shumë projekte, plane dhe rregullore ose do të anulohen ose do të shtyhen për një kohë të pacaktuar. Komunat do të dalin më të dëmtuara në fushën e të hyrave komunale dhe investimeve kapitale. Komunat do të kenë dukshëm më pak të hyra nga tatimi në pronë, të hyra nga hapësirat publike, nga gjatë në trafik, nga taksa për regjistrimin e automjeteve dhe nga qiraja nga objektet publike. Rënia e të hyrave do të përcillet me pamundësi të realizimit të disa projekteve kapitale. Të vetëdijshëm për këtë gjendje, Qeveria e Kosovës, në pakon e parë emergjente ekonomike, ka ndarë 10 milionë euro për komunat e Kosovës që do të shfrytëzohen për tejkalimin e pasojave të krijuara nga masat e ndërmarra në parandalimin e virusit COVID-19.

Nga gjysma e muajit mars 2020 e tutje, komunave të Kosovës me qëllim të përballimit të kësaj gjendje dhe aplikimit të masave emergjente, u është lejuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve përdorimi i një kodi të veçantë buxhetor për t'i shfrytëzuar një pjesë të mjeteve të parapara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe përdorimit të procedurës së negociimit në fushën e prokurimit publik, pa pasur nevojë për shpallje përkatëse.

Komunat, përveç pamundësisë për të mbajtur mbledhje të rregullta të saj, e kanë pasur të pamundur pas datës 13 mars edhe mbajtjen e konsultimeve publike me qytetarë në lidhje me planet dhe projektet e komunës. Komunat do të rrezikojnë të futen në periudhën e rishikimit buxhetor, pa pasur mundësi të zhvillojnë konsultime publike të drejtpërdrejta me qytetarë.

Aneks

Projektet kapitale që do të ndikohen në kohëzgjatjen e realizimit nga efektet e masave kundër pandemisë COVID-19 në 16 komuna

Zhvendoset në pjesën e dytë të vitit

Shtyhet për disa muaj

Mund të largohet nga lista e investimeve me rishikim të buxhetit

Komuna	Statusi	Projekti	Vlera (Euro)
Prishtinë		Ndërtimi i Sheshit 'George Bush' (nga hotel "Grandi" deri të Katedralja)	500,000
		Shtirja e sistemit të ujitjes në parqet e qyteti	200,000
		Toaletet publike në parkun Germia dhe parqe të tjera	40,000
		Ndërtimi i rrugëve "Agim Ramadani" "Ibrahim Lutfiu", "ILaz Agushi"	500,000
		Ndërtimi i Tunelit (300 metra) në Rrugën "Agim Ramadani"	2,000,000
		Ndërtimi i rrugës Stallovë-Zllash	450,000
		Ndërtimi i rrugicës në Prapashticë, Nishevc dhe Marevc	100,000
		Hapja e rrugëve te reja në Komunën e Prishtinës	500,000
		Ndertimi I QMF-se Veternik	600,000
		Hapja e puseve per ujitje te oborreve të shkollave	180,000
		Nisja e punëve në parkingun nëntokësor të fakulteti filologjik (PPP)	
		Ndërtimi i QMF - Prishtina e Re Zona Perendim	400,000
	Drenas		Kanalizimet e ujërave të zeza në fshatrat Gradicë Likoshan
		Kanalizimet e ujërave të zeza në fshatrat Gllanasellë- Godanc	30,000
		Kanalizimet e ujërave të zeza në fshatrat Dobroshec - Çikatovë e Vjetër	60,000
		Kanalizimet e ujërave te zeza në fshatrat Komoran	80,000
		Kanalizimet e ujërave te zeza në fshatrat Verboc Shtuticë	20,000
		Kanalizimet e ujërave te zeza në fshatrat Terstenik I dhe II	55,000
		Kanalizimet e ujërave te zeza në fshatrat Baicë, Krajkovë dhe Shtrubullova	40,000
		Kanalizimet e ujërave te zeza në fshatrat Llapushnik Poterk Vukoc:	65,000
		Kanalizimet e ujërave te zeza në fshatrat Abri e Eperme dhe Terdec	65,000
		Kanalizimet e ujërave te zeza në fshatrat Korroticë e Eperme e Ulet dhe Poklek i Ri e i Vjetër	105,000
		Kanalizimet e ujërave te zeza në fshatrat Nekoc dhe Kizhnarekë	40,000
		Ndertimi i kolektorve per grumbullimin e ujrave te zeza ne Komunë	420,000
Ferizaj		Ndërtimi i Palestrës për sporte luftarake	40,000
		Ndërtimi i Palestrës sportive në qytet	70,000

Gjakovë	Ndertimi i terreneve sportive në shkolla	110,000
	Zhvillimi i pikes turistike në Lumin Erenik	25,000
	Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Brekoc-Devë	50,000
	Sanimi i ujrave të zeza dhe atmosferike	100,000
	Ndertimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Korenic	130,000
	Ndertimi i Parkingjeve në Qytet	170,000
	Ndertimi - asfaltimi i rruges Dervish Shaqa - Osek Hylë	170,000
	Ndertimi i rruges Rracaj - Rripaj	140,000
	Ndertimi i kanaleve të ujitjes në zona rurale	340,000
Gjilan	Ndërtimi i zyres se gjendjes civile në lagjen “Arbëria”	60,000
	Asfaltimi i rrugëve në lagjet “Junuz Terstena”, dhe fshatrat Shillovë, Malishevë dhe Uglar.	450,000
	Ndërtimi i ures në fshatin Livoq i Epërm	30,000
	Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore në fshatrat Cernicë dhe Ponesh	200,000
	Rregullimi i zones (parkut) Banja	347,000
Istog	Investimet në stacionin e autobusëve	5,000
	Ndertimi i rrugeve në lubove, lagja “Haxhijaj”, “Kajtazaj” dhe “Hajdaj”	35,000
	Rregullimi i infrastrukturës në shf “Ndre Mjeda” në fshatin Rakosh	133,000
	Renovimi i objektit social dhe rezidencia	50,000
	Investimet në ngrohjen qendrore në çerdhet e qytetit	30,000
Lipjan	Asfaltimi i rrugicave në fshatin Poturovc	53,000
	Asfaltimi i rrugeve në fshatin Kraishte	68,000
	Ndertimi i trotuareve në Babush	25,000
	Ndertimi i trotuareve me ndriqim publik në Sllovi	79,000
	Asfaltimi i rrugëve në Fshatin Gadime e Eperme	183,000
	Asfaltimi i rrugeve në fshatin Gadime e Ulet	205,000
	Asfaltimi i rrugeve në Krojmir	137,000
	Asfaltimi i rrugicave ne Gllogovc	66,000
	Ndertimi i 5 fushave sportive(Teqe, Kojске,Gllanic, Jeta e re, Qallopek)	24,000
	Ndertimi i çerdhes në fshatin Gadime	250,000
	Rregullimi i stadiumit në Dobraje dhe Magurë	134,000
Prizren	Ndertimi i zyres se vendit në Reqane	5,000
	Ndërtimi i kanalizimit në Landovicë	110,000
	Rehabilitimi i infrastrukturës nëpër rrugët e qytetit	150,000
	Rregullimi i parkingut në qytet	90,000
Pejë	Asfaltimi i rruges Ura e Gurit	120,000
	Ndertimi i mureve mbrojtese në lagjen Kapeshticë	120,000
	Ndertimi i mureve mbrojtese në fshatin Bogë	35,000
	Rregullimi i kanaleve të hapura në Katundin e Ri	60,000
	Rregullimi i kanaleve te hapura në “Xhemajl Kada” dhe “2 Korrik”	85,000
	Rregullimi i kanaleve te hapura ne Kristal	25,000
	Renovime te Shkollave	38,000

Podujevë	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dobërdol	40,000
	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Metergofc	165,000
	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Buricë	40,000
	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Gërdofc	50,000
	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Batllav	60,000
	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Llapashticë	60,000
	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shajkofc	60,000
	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Tërnavë	50,000
	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Sibofc	60,000
	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Penuhë	40,000
	Ndërtimi i rrugës në fshatin Revuçë	40,000
	Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dumnicë	50,000
	Ndërtimi i urave në Zhiti	12,000
	Renovimi i objekteve shëndetësore	70,000
	Ndërtimi i fushave sportive	30,000
Rahovec	Ndërtimi i tregut të gjelbër	10,000
	Riparimi i shkollave	20,000
	Ndërtimi i QMF-se në Apterush	30,000
Shtime	Zgjerimi i rrugës “Ahmet Shtimja”	60,000
	Rregullimi i kanalizimit dhe ujrave të zeza në fshatin Godancë	60,000
	Rregullimi i kanalizimit dhe rrugës në fshatin Luzhak	90,000
	Rregullimi i trotuarit në fshatin Muzeqin	50,000
	Renovimi i objektit të komunës	15,000
	Ndërtimi i terreneve sportive	50,000
	Ndërtimi i objektit të QMF në Pjetershticë	40,000
	Rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavor	30,000
	Renovimi i objekteve shkollore	50,000
Suharekë	Fasadimi i banesës së kalter dhe banesës pranë rrugës “Abdyl Rama”	15,000
	Ndërtimi i çerdhes të femijeve në Samadraxhë-Faza e II	38,000
	Rregullimi i infrastruktures për Çerdhen e Fëmijëve në Studenqan	45,000
	Ndërtimi dhe meremetimi i shkollave	38,000
	Rregullimi i kanalizimit në Bllacë	25,000
	Rregullimi i rrugëve “Kodra e Trimave”, rr. Xhelë Muslia, në Doberdelan.	30,000
	Ndërtimi i rrugëve lokale “11 Martirët” “Rezina”	20,000
	Instalimi i ngrohjeve qendrore dhe riparimi i atyre eksistuese në QKMF,QMF dhe AMF	15,000
	Ndërtimi i sistemit të ujitjes për siperfaqet bujqësore	25,000
	Pastrimi dhe rregullimi i lumenjëve në Komunë	20,000
	Rregullimi i kanalizimit në Studenqan	20,000
	Rregullimi dhe sanimi i rrugëve lokale në Komunë	30,000

Vushtrri	Ndërtimi i kiosqeve në sheshin "Adem Jashari"	10,000
	Ndërtimi i kanalizimeve në zonat rurale	50,000
	Ndërtimi i ujësjellëseve në zonat rurale	200,000
	Ndërtimi i stacionit të autobusëve	15,000
	Renovimi i QMF dhe instalimi i ngrohjes qendrore	15,000
Kamenicë	Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në zonat urbane dhe rurale	30,000
	Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në zonat urbane dhe rurale	50,000
	Mirëmbajtja e ndriqimit publik	5,000
	Ndërtimi i objektit të shtëpia e komunitetit	10,000
	Paisja e shkollave me paisje laboratorike	5,000
	Ngrohja qendrore në shkolla	10,000
	Renovimi i shkollave	15,000
Obiliq	Ndërtimi i sheshit	2,100,520
	Ndërtimi i rrugëve në disa lagje të fshatit Hade e Re	100,000
	Ndërtimi dhe renovimi i objektit për rastet sociale	50,000
	Instalimi i kanalizimeve në zona	150,000
	Instalimi i ujësjellësit në disa zona	85,000
	Ndërtimi i ambulancës në Breznicë	50,000
	Ndërtimi i bibliotekes	50,000

Burim: Drejtoritë komunale sipas planeve të investimeve për gjashtëmuorin e parë të 2020


Instituti GAP është një think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4, 10000 Prishtinë

Tel: +383 38 609 339

info@institutigap.org



Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga



